

VENDIM
Nr. 287, datë 17.4.2026

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE
TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË
SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2026, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilat lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, është 61 (gjashtëdhjetë e një) pozicione të kategorisë së mesme dhe të ulët drejtuese.

3. Pozicionet në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil për nivelin e mesëm drejtues dhe për nivelin e ulët drejtues, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

Lidhja 1

**POZICIONET NË TË CILAT MUND KONKURROJNË EDHE KANDIDATË NGA
JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

1. Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm

1. Jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave në Kryeministri;

2. Koordinator në Drejtorinë e Koordinimit Ndërinstitucional dhe Kapaciteteve në Njësinë për Integrimin Evropian në Departamentin e Politikës dhe Integritimit Evropian në Kryeministri;

3. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore;

4. Koordinator në Sektorin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në Drejtorinë e Programimit Strategjik në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

5. Drejtor i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit;

6. Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes;

7. Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit dhe Menaxhimit të Projekteve në Fushën e Artit dhe Kulturës në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Artit, Kulturës dhe Rinisë në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

8. Drejtor i Drejtorisë e Administrimit të Fondit të Trashëgimisë Kulturore dhe Projekteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

9. Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Hartimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

10. Drejtor i Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave për Turizmin, Kulturën, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

11. Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

12. Drejtor i Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar në Ministrinë e Financave;

13. Drejtor i Zyrës (Drejtoria) Mbështetëse ZKA në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Fondeve të BE-së në Ministrinë e Financave;

14. Drejtor i Departamentit Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;

15. Drejtor i Departamentit të Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;

16. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

17. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

18. Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Regjistrave në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

19. Drejtor i Drejtorisë së Projekteve në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;

20. Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pronës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;

21. Drejtor i Drejtorisë për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimit Ndërgjyqësor në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë;

22. Drejtor i Drejtorisë së Përkthimit Zyrtar për Bashkëpunimin Ndërgjyqësor dhe Certifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë;

23. Drejtor i Drejtorisë së Politikave Farmaceutike dhe Pajisjeve Mjekësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

24. Drejtor i Drejtorisë së Projekteve, Emergjencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

25. Drejtor i Drejtorisë së Inovacionit dhe Inteligjencës së të Dhënave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

26. Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

27. Drejtor i Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI);

28. Drejtor i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Mjedisit;

29. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Sigurimeve Shoqërore në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve Shoqërore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit;

30. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Aftësimit Profesional dhe Inspektimit AFP në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Punësimit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit;

31. Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

II. Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm

1. Koordinator në Drejtorinë e Koordinimit Ndërinstitucional dhe Kapaciteteve në Njësinë për Integrimin Evropian në Departamentin e Politikës dhe Integritimit Evropian në Kryeministri;

2. Analist në Sektorin e Kërkimeve në Drejtorinë e Programimit Strategjik në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

3. Përgjegjës i Sektorit të Hetimit Administrativ në Drejtorinë e Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit;

4. Përgjegjës i Sektorit të Arsimimit, Kualifikimit dhe Zhvillimit të Karrierës së Personelit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes;

5. Drejtor i Agjencisë Rajonale të Bregdetit Vlorë;

6. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Inspektimit të Zonave Bregdetare dhe Veprimtarive Turistike në Agjencinë Rajonale të Bregdetit Lezhë;

7. Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit të Biznesit në Drejtorinë e Implementimit të Operacioneve Tatimore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

8. Përgjegjës i Sektori të Taksimit të Dyfishtë në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

9. Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Gjyqësore në Drejtorinë e Trajtimit të Ankesave, Marrëdhënieve me Institucionet dhe Çështjet Juridike në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;

10. Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Administratën e Prefektit të Qarkut Durrës;

11. Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër;

12. Përgjegjës i Sektorit të Shëndetit, Mbrojtjes së Bimëve dhe Mbetjeve në Drejtorinë e Politikave të Shëndetit të Bimëve, Farërave, Fidanëve dhe Plehrave në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

13. Përgjegjës i Sektorit të Produkteve Veterinare dhe Mbetjeve në Drejtorinë e Politikave Veterinare në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

14. Përgjegjës i Sektorit të Bazës Eksperimentale/Prodhuere në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë;

15. Koordinator në Sektorin e së Drejtës Ekonomike, Financiare, Industriale dhe Sipërmarrjes në Drejtorinë e së Drejtës Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë;

16. Ekspert Mjeko-Ligjor (pranë qarkut Gjirokastrë) në Sektorin e Ekspertizës Mjekoligjore pranë Qarqeve në Institutin e Mjekësisë Ligjore;

17. Ekspert Mjeko-Ligjor (pranë qarkut Korçë) në Sektorin e Ekspertizës Mjekoligjore pranë Qarqeve në Institutin e Mjekësisë Ligjore;

18. Ekspert Mjekoligjor në Sektorin e Ekspertizës Mjeko-Ligjore, Kërkimit Shkencor dhe Specializimeve në Institutin e Mjekësisë Ligjore;

19. Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Zhvillimit të Shërbimit Spitalor në Drejtorinë e Politikave të Shërbimit Spitalor në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

20. Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes ndaj Dhunës në Familje në Drejtorinë e Barazisë Gjinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Mirëqenien Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

21. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Programeve dhe Projekteve Financuar nga Donatorët e Tjerë në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve për Çështjet e Zhvillimit Ekonomik dhe Inovacionit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit;

22. Përgjegjës i Sektorit të Digjitalizimit në Drejtorinë e Transformimit Digjital në Drejtorinë e Përgjithshme të Inovacionit dhe Teknologjisë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit;

23. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit nr. 1 në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.